

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT MINISTRIA E PUNES DHE MIRËQENIES SOCIALE Ministarstvo Rada - Socijalne Zastine - Ministry of Labour and Social Welfare Sektorri Arkivi - Sektor Arhive - Archive Sector	
Qësia Org Org. Identifikim Org. Titull Nr. Organizatës Nr. Projektit	Nr. Prot. Detyr. Prot.: 157 Prot. Nr.: Data: Detyr. Data: 26.04.2017 Date:
Prishtine - Prishtina - Prishtina	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Ministarstvo Rada i Socijalne Zastine - Ministry of Labour and Social Welfare

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale,

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 38 të Ligjit Nr. 03/L-189, për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, 21 tetor 2010), duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 5 dhe 6), të Rregullores Nr. 02/2011, për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), duke pasur parasysh Vendimin e Qeverisë Nr. 02/78 dt.09.03.2016 për ndryshimin e qëllimit të përdorimit të kompleksit banesor-afarist “Hade dhe Hade 2”, dhe vendimit nr.09/41 i dt. 07.04.2017 për plotësimi dhe ndryshimin e Vendimit Nr. 02/78 dt.09.03.2016, nxjerr:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni për përzgjedhjen e përfituesve të së drejtës në banim, për familjet që janë raste sociale.
2. Komisioni sipas pikës një (1) të këtij vendim përbëhet prej pese (5) anëtarëve:
 - 2.1. Gani Smakaj, Departamenti i Familjes dhe Politikave Sociale-MPMS, Kryesues i Komisionit,
 - 2.2. Mexhid Krasniqi, përfaqësuese nga Qendra për Punë Sociale-Obiliq, anëtarë;
 - 2.3. Burim Gërguri, Drejtor i Shërbime Publik dhe Emergjencia, KK-Obiliq, anëtar,
 - 2.4. Merita Dalipi, Zyrtare e Lartë për banim social/MMPH, anëtare;
 - 2.5. Bilall Xani, Koordinator Regjional për Regjionin e Prishtinës-Nëna Terezë, anëtar.
3. Në Komision, pjesëmarrës do të jetë edhe një përfaqësuese në cilësinë e vëzhguesit nga shoqëria civile.
4. E drejta në banim për përfituesit nga kjo kategori, bëhet në Kompleksin kolektiv banesor-afarist “Hade dhe Hade 2”, Komuna e Obiliqit.

5. Në kompleksin kolektiv, pesëdhjetë (50 %) të njësisve banesore destinohen për qëllimin e zgjidhjes së banimit të familjeve që janë raste sociale.
6. Komisioni për përzgjedhjen e përfituesve të së drejtës në banim për familjet që janë raste sociale vendosë në bazë të procedurave të parapara me Ligjin Nr/03/L-164, për financimin e programeve të veçanta të banimit, Udhëzimit Administrativ Nr.21/2010, për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit, Udhëzimit Administrativ Nr.22/2010 për procedurat e përfitimit nga programet e veçanta për banim, Udhëzimit Administrativ Nr.23/2010 për procedurat e shpalljes së programeve të veçanta të banimit, Udhëzimit Administrativ Nr.24/2010 për normat minimale të banimit për banesat nga programet e veçanta të banimit të nxjerra në bazë të këtij ligji.
7. Komisioni në takimin e parë do vendos për metodologjinë e punës për të gjithë procesin e përzgjedhjes për përfituesit e të drejtës në banim.
8. Komisioni, vlerësimin e gjendjes së banimit në teren, të familjeve si dhe verifikimin e të dhënave të kërkuessve e bënë në afat prej tridhjetë (30) ditësh.
9. Pas vlerësimit të gjendjes së banimit nga tereni i familjeve nga ana e Komisioni, Komuna publikon listën e familjeve të renditura sipas pikëve të fituara gjatë vlerësimit.
10. Mandati i Komisionit zgjat deri në dhënien në shfrytëzim të njësisve banesore për përfituesit të së drejtës në banim sipas pikës pesë (5) të këtij vendimi.
11. Komisioni për punën e vet i përgjigjet dhe i raporton Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.
12. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Izedin Bytyqi


Sekretar i Përgjithshëm i MPMS-së

Vendimi i dërgohet:

- Anëtareve të Komisionit
- Zyrës së Ministrit
- Arkivit të MPMS.